



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë pune pranë Autoritetit të Medieve Audiovizive

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Besnik Baraj (deputet zëvendësues) dhe Anduel Xhindi (deputet zëvendësues).

Mungojnë:

Musa Ulqini, Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Prezent:

Gentian Sala – Kryetar i Autoritetit të Medieve Audiovizive,

Sami Neza – nënkryetar i Autoritetit të Medieve Audiovizive,

Vera Muça – sekretare e Përgjithshme e Autoritetit të Medieve Audiovizive,

Arben Muka – drejtor i Programacionit të Autoritetit të Medieve Audiovizive.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirësejugujetëm!

Në kuadër të kontrollit parlametar që zhvillon komisioni, menduam të bëjmë një vizitë në mjediset, ku zhvillon veprimtarinë AMA. Do të ishte e nevojshme për të parë nga afër institucionin dhe për të takuar punonjës të tjerë të autoritetit, me të cilët nuk kemi pasur mundësinë të takohemi gjatë mbledhjeve në komision.

Pjesëmarrja në këtë takim edhe e anëtarëve të bordit të Autoriteti dhe të Këshillit të Ankesave, i jep më shumë mundësi anëtarëve të komisionit të marrë një pasqyrë më të plotë të procesit vendimmarrës brenda autoritetit.

Gentian Sala – Bordi i AMA-s funksionon goxha mirë. Ne kemi njohuri çfarë ndodh me bordet në Shqipëri. Ky është nga bordet për të cilin debatohet më shumë dhe kjo është gjë shumë pozitive. Nga jashtë dukemi si solidë, përveç ngjarjeve të fundit, por nga brenda është një bord në të cilin debatohet jashtë mase.

Administrata jonë është shumë e konsoliduar dhe nga më të mirëtrajnuarat në rang republike, e trajnuar brenda vetë administratës, ku çdo një muaj bëhen trajnime. Për shembull, drejtori i Mbikëqyrjes kryen trajnime me stafin e tij, me stafin e drejtorisë tjetër, për të kryqëzuar eksperiencat.

Është zgjidhur ngërçi i digjitalizimit, një ngërç ligjor, që ka krijuar një kosto prej miliona eurosh. Ndaj brezi digjital Dividend DVB-T2-shi, që po shitet tani, po të ishte shitur para katër vjetësh, mund të vlente të paktën 20-30 milionë euro më shumë. Pra, nuk është punë qejfi, por punë tregu. *Mobile*-eve sa vjen e u bien xhirot, ndërsa kjo ka mbetur në ngërç edhe prej punës së AMA-s, ndoshta edhe prej konflikteve të tjera, por në radhë të parë prej punës së AMA-s. Tashmë ky problem është zgjidhur, po ashtu ngërçi me operatorët...

Thatë që vendimet e AMA-s do të sjellin monopole, por, në fakt, nuk ka monopole. Kjo, sepse pas vendimeve tona, nuk ka pasur efekte që çojnë në monopol. Sot secili aktor që do të futet në treg, ka në treg hapësirën për t'u futur, për të konkurruar.

Teknologjia bën të veten. U jemi përshtatur të gjitha zhvillimeve të fundit teknologjike, me rregullore, sidomos për teknologjitë e reja, si: IPTV, OTT-të, pra kemi ecur jo siç është tradita në shumë institucione, ku ecën privati, një herë fluturon dhe institucioni shkon mbrapa, por ne kemi ecur paralelisht me zhvillimet e reja, që edhe i përmenda.

Kemi zgjidhur deri më një problemin e tarifave. Sot nuk ka asnjë operator, por të gjithë operatorët e mëdhenj, nuk është ndonjë sekret të përmend emra, madje i kemi çuar edhe shkresë Kuvendit: “Supersport”, “Tring”, “Klan” e të tjerë kanë pasur debi tek AMA, ndërkohë që sot janë në zero. E bëmë këtë zero, sepse filluam me të mëdhenjtë, nuk e filluam me operatorët e vegjël të rretheve.

Tregu i operatorëve kabllorë është goxha i konsoliduar dhe është i rregulluar më mirë sesa më parë. Vetëm nga mbikëqyrja që u kemi bërë operatorëve dhe akteve rregullative, në qoftë se ka pasur 119 operatorë kabllorë, sot ka 60. Nuk është qejf që janë mbyllur, sepse nuk është se janë mbyllur. Pjesa më e madhe e tyre janë *merged* me njëri-tjetrin: ka ndodhur që një operatori AMA i jepte nga katër licenca në një zonë me 5000 banorë. Pra, normale që ato do të vidhnin, se nuk u dilte. Ne jo vetëm me presion...

(Deputeti Baraj flet pa mikrofon.)

Ligjin varet si e interpreton. Ligji autorizon operatorët kabllorë. Por ajo nënkupton që do të bësh akte rregullative. Si mund të japësh pesë licenca në një zonë me 3000-4000 operatorë? Pse ka pak operatorë...? Për shembull, e gjithë Maqedonia ka 35 operatorë; Kosova ka 35-40 operatorë, ndërsa ne kishim 119 të tillë, me popullsi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse? Sepse nuk bënim as studim, as shikonim si i jepnim dhe krijojmë konflikte. Të gjithë vidhnin. Edhe unë sikur të isha tek ajo zonë do të vidhja, se nuk do t’ia dilja dot me katër operatorë, ose do të fragmentoja... Ne nuk e kemi fort traditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëpërmjet inspektimeve që kemi bërë, nëpërmjet akteve rregullative kemi dhënë të kuptojmë se situata nuk vazhdon më ashtu. Kush është shitur, cilët janë bashkuar me njëri-tjetrin, kanë krijuar struktura më solide të funksionimit.

Milva Ekonomi – Po struktura juaj si është ndërtuar? Do të na flisni pak për strukturën e AMA-s?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Thelbi i AMA-s është bordi, i cili përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe pesë anëtarë. Unë dhe zoti Neza jemi me kohë të plotë, ndërsa anëtarët vetëm kur ka mbledhje. Zonja Vera Muça është sekretare e Përgjithshme, zoti Muka është drejtor i Programacionit, që është, le të themi, drejtorja kryesore, ndërsa zonja Sara Xhumbari është drejtoreshë Juridike, pastaj kemi Këshillin e Ankesave, i cili është një bord brenda bordit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Administrata është e plotë.

Janë gjashtë drejtori, ku përfshihen: Drejtoria e Programeve, Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK-ut, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Mbikëqyrjes, shefi i kabinetit dhe këshilltarët.

Milva Ekonomi – Domethënë, keni drejtori programacioni, drejtori juridike...

Gentian Sala – Ky informacion gjendet edhe në faqen zyrtare të AMA-s.

Këshilli i Ankesave, që është një bord tejet i rëndësishëm... Pse është i rëndësishëm? Sepse në qoftë se në bordin e AMA-s, atë kryesor, që e zgjedh parlamenti, profesionet mund të jenë nga më të ndryshmet... për shembull, unë jam me *background* juridik, biznes, OJF, ndërkohë që Këshilli i Ankesave përbëhet edhe nga gazetarë, me eksperiencë mbi dhjetë vjet, që merren me ankesa specifike. Pra, në qoftë se ka ankesa të natyrës konfliktuale të një qytetari me Autoritetin e Medieve, është Këshilli i Ankesave që i shqyrton dhe jo bordi i AMA-s. Për momentin ky këshill ka në përbërjen e tij vetëm kryetarin dhe dy vakanca, të cilave u janë hapur procedurat.

Milva Ekonomi – Nga tre veta përbëhet Këshilli i Ankesave?

Gentian Sala – Po, por këshilli mbështetet edhe nga administrata e AMA-s, sepse varet nga volumi që ka. Vetëm vitin e kaluar njëri prej anëtarëve ka pasur 72 ankesa për të shqyrtuar.

Kryetar është zoti Urim Bajrami, gazetar me eksperiencë; më parë ka qenë drejtues i gazetës “Shqip”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Në komision na ka ardhur një ankesë e tillë: a monitorohet nga AMA fakti që shumë shpesh në media dalin fytyrat e fëmijëve?

Gentian Sala – Në qoftë se vitet e fundit është bërë ndonjë punë...

Milva Ekonomi – Fëmijëve nëpër lajme nuk u prishet “fytyra”.

Gentian Sala – ... është bërë për fëmijët.

Milva Ekonomi – Kjo është një ankesë e ardhur në komision.

Gentian Sala – Kur është e përgjithshme, është tjetër gjë, por kur është specifike...

Milva Ekonomi – Në rregull.

Gentian Sala – Ankuesi duhet të thotë ku, kush, çfarë ore, çfarë dite.

Pra, është bërë lirimi i brezit të frekuencave, është zgjidhur problematika e operatorëve digjitalë, është bërë implementimi i digjitalizimit, sepse që të zbrisje operatorët kryesorë “Tring”, “Digitalb”, “Klan” e të tjerë nga brezi i frekuencave digjital dividend 2 nuk ka qenë

një gjë thjesht teknike, por duhej të investoheshin miliona euro që të zbrisnin poshtë. Kjo ka ardhur nëpërmjet një komunikimi të vazhdueshëm.

Në datën 10 shtator, kur ka ndodhur edhe një...sepse normalisht si ju, si publiku, e keni parë konfliktin që ka ndodhur me qytetarët që shkonin për të blerë dekodera. Atë ditë kanë ndodhur tre procese njëkohësisht. Për herë të parë, pas njëzet vjetësh, qëkur janë krijuar mediet, në të gjitha zonat kryesore urbane nuk ka asnjë operator të paligjshëm. Kjo nuk ka ndodhur ndonjëherë në Shqipëri, që prej kohës kur kanë filluar mediet në vitin 1996-1997. Gjithmonë hipnin e vinin antena si të donin, pastaj u krijua ligji, u krijua KKRT-ja, por gjithmonë...

Milva Ekonomi – Tani prapë kemi 119 transmetues lokalë?

Gentian Sala – 60 a më pak dhe sot nuk ka asnjë frekuencë të paligjshme, as analoge, as digjitale. Në Tiranë, Durrës, Elbasan, në zonat kryesore të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Atje ku ka më shumë popullatë.

Gentian Sala – Kjo ka ndodhur për herë të parë më 10 shtator.

Gjëja e fundit që prisnim të shihnim ishin problemet që ndodhën me qytetarët. Me thënë të drejtën, nuk e prisnim. Ka ndodhur edhe në shtete të tjera, por ngaqë kishim eksperiencën e Beratit, të Korçës dhe të Fierit thamë se do të ishte një situatë normale. Por nuk rezultoi ashtu. Prandaj edhe pati një kthim mbrapsht.

Milva Ekonomi – Për të telefonuar në familje, është nismë juaja?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka pasur komunikime të tilla: “Ju marrim nga Autoriteti i Medieve Audiovizive dhe ju vëmë në dijeni se deri më 31 dhjetor ju duhet të kaloni në një...”. Mua më kanë telefonuar për njoftimin se duhet të kaloj...

Keni ndonjë projekt të tillë?

Gentian Sala – Jo.

Milva Ekonomi – I ka qëlluar ndonjërit prej jush t’ju telefonojnë nëpër familje dhe t’ju thonë: “Ju marrim nga Autoriteti i Medieve”...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Po, ndoshta RTSH-ja.

Milva Ekonomi – Jo, jo, nga AMA, sepse unë bëj shumë kujdes kur më vjen ky “zëri”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – AMA ka bërë vetëm një herë një studim dymujor, këtu e dhjetë muaj para për audiencën, por si kjo që thoni ju nuk kemi bërë.

Milva Ekonomi – Kjo ishte tani dhe unë mendova se do të jetë ndonjë aktivitet i AMA-s që na bën me dijeni, domethënë njofton qytetarët e zakonshëm që duhet të bëjnë kujdes dhe të blejnë...

Gentian Sala – Është *fake news*.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Domethënë, kemi pasur të bëjmë me një *fake activity*, sepse ky nuk është lajm, në fakt.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Vitin e kaluar AMA është hequr për herë të parë nga lista e raportimit që bënte Bashkimi Europian, si institucion problematik, madje është hequr si institucion politik që kur është krijuar.

Çfarë është kryesorja, që ta mbyll apo për ta bërë diskutimin më të gjallë, është që prej më se një viti a një viti e gjysmë ne jemi fokusuar tek ajo që duhet të jetë puna jonë kryesore, që është programacioni.

Ligji “Për mediet audiovizive” është shumë i detajuar dhe mbi 60% e tij flet për programacionin. Këtu kemi filluar edhe fokusin tonë kryesor. Por ka ardhur gradualisht, se nuk mund të merreshim dot me një problem emisioni, kur ai operator as paguante paratë, kishte frekuencë të paligjshme, domethënë nuk kishte elementet kryesore.

Jam i mendimit të vijojmë me pyetje-përgjigje.

Milva Ekonomi – Doni të vijojmë me pyetje? Çfarë pyetjesh mund t’ju bëjmë?

Gentian Sala – Pyesni Samiun...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Po vazhdoj me shqetësimin që përmendi edhe Milva: çfarë detyrimi ka AMA dhe a ka marrë masa qoftë organizative, qoftë teknike, që të mos përsëritet, lidhur me kalimin e transmetimeve nga numerike në digjitale? Ky ishte një fenomen, që pati reaksion me qytetarët dhe ishin të papërgatitur. A keni ju një përgjegjësi për këtë punë? Mendoni se keni...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë masash paraprake keni përgatitur për këtë punë, në mënyrë që të mos ndodhë prapë ndonjë fenomen?

Gentian Sala – Faktikisht këtu ka edhe një ndërthurje. Bashkëpunimi ndërinstitutional ka bërë një gjë të mirë, që në këtë lojë është futur disi edhe Autoriteti i Konkurrencës, i cili, pas një komunikimi bashkë, ka marrë një vendim, ku na kërkon që, së pari, të raportojmë çfarë masash kemi marrë dhe, së dyti, njëfarë rekomandimi se çfarë do të bëjmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vendimet e Autoritetit të Konkurrencës, si për operatorët publikë e privatë, janë të detyrueshme. Kështu që, atë vendim e kemi marrë shumë seriozisht dhe jemi në finalizimin e një strategjie të re komunikimi, e cila, për fat të keq, nuk kapet dot më 15 janar, që është edhe afati...

Ismet Beqiraj - Do të shtyhet afati përsëri?

Gentian Sala – Këtë do ta komunikojmë edhe në bord, sepse kjo është edhe një nga arsyet pse kemi pasur një lloj konflikti në bord pas datës 10 shtator. Tradita ka qenë që vendimet i merrte institucioni, kryetari me administratën në bord, ndërsa kësaj radhe për 10 shtatorin e gjykoi që duhet të komunikoni edhe me bordin. Pra, edhe këtë aspekt do ta kemi pjesë të mbledhjes së bordit. Nuk mund të them me përgjegjësi se çfarë do të bëjmë, por nuk është çudi opsioni i shtyrjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – A mund ta përsërisim pak? Si ishte kjo që sapo thatë? Çfarë ndodhi që nga data 10 shtator?

Gentian Sala – Pas datës 10 shtator, kur u bë mbyllja e Tiranës, pati një konflikt në bord, ku u kërkua shkarkimi i kryetarit nga katër anëtarë të bordit. Me të drejtë ose jo, është tjetër gjë.

Është kërkuar që bordi të marrë vendim për digjitalizimin, ndërkohë që praktika nuk ka qenë kjo. Praktika ka qenë si në Berat, në Korçë, Fier, ku procedurat i kishte kryetari me administratën.

Duke pasur parasysh këtë, kjo gjë do të diskutohet në bord më në detaje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj - Kjo ndodhi kur u propozua që transmetimi të kalohej në formën tjetër?

Gentian Sala – Po, për Tiranën dhe Durrësin. Zonat e tjera vazhdojnë sipas një lloj tradite, ndërsa këtë radhë... Normalisht janë futur edhe dy hallka të tjera në mes. Kjo nuk është ndonjë gjë e keqe, por do komunikim më të fortë si me Autoritetin e Konkurrencës, si me ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por nuk mund të thuhet se ka një faj, se është kollaj të thuash: “Më fal, është faj!”, kjo ka ndodhur edhe në vendet e tjera. Janë bërë hapa para, janë bërë hapa pas. Ndërkohë, të mos harrojmë se qytetarët, të cilët e kanë blerë, nuk kanë humbur asgjë, veçse kanë më shumë kanale me më shumë cilësi, plus po vazhdojnë t’i blejnë.

Me thënë të drejtën, edhe po u la pak kohë, nuk është keq, pasi edhe operatori publik, nisur nga komunikimet që kemi, dëshiron të futet te kjo pjesë, që të ofrojë dekodera. Pse po ecën pak më *soft*, nuk është ndonjë humbje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Doja të shtoja diçka në këtë vazhdim, institucioni juaj ka vendosur gjoba për operatorët që kanë shkelur ligjin në tregun audioviziv?

Gentian Sala – E gjerë si pyetje.

Po, ka vendosur gjoba, por gjobat kanë qenë për piraterinë, për programacionin, për daljet nga frekuenca, për mosmbulimin me frekuencë e të tjerë. Gjobat menaxhohen nga administrata, plus, siç është rregulli, kur bëhet... Jemi nga institucionet në shtet që kemi mbledhjen më të madhe të të ardhurave nga gjobat, të cilat menaxhohen 80% nga buxheti i shtetit dhe 20% nga institucionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Problematika e së drejtës së autorit ka dalë si shqetësim?

Gentian Sala - Ajo është një nga pikat e zeza që kanë ngelur në institucione. Ne kemi pasur shumë probleme me të drejtën e autorit. Kjo, në radhë të parë, pasi kemi gjykuar që, si institucionet publike që kanë menaxhuar ..., për shembull, Drejtoria e të Drejtës së Autorit, ashtu edhe agjencitë, nuk kanë qenë konform ligjit. Më shumë na janë dukur si gjë false sesa si kompani që mbrojnë të drejtat e autorit. Nuk është se jemi marrë më pak, por kemi komunikuar me ta dhe kemi mbledhur operatorët. Kur mbledhen operatorët bashkë me zyrën e të drejtës së autorit dhe me agjencitë, në vend të operatorëve ka pasur një rreth shumë të madh, sidomos kabllorët, radiot dhe televizionet.

Pas takimit, ngaqë nuk u zgjidhën gjërat, Zyra e të Drejtës së Autorit ka vënë gjoba në të gjitha televizionet, kryesisht radio, televizione kabllore. Në këtë rast ne ishim në krahun e operatorëve. Ata jo vetëm që nuk bënë zgjidhje, por filluan masat represive. Që atëherë kemi pasur mungesë shumë të madhe bashkëpunimi. Këtë e kemi bërë parimisht. Aty ka një ngërç që shteti u jep dy institucioneve të drejtën për të vënë gjoba. Pra, unë mund t'i vë gjobë operatorit, por edhe Zyra e të Drejtës së Autorit mund t'i vërë.

Ne kemi thënë që pa pasur informacion kujt i vë ti, unë s'mund t'i vë.

Besnik Baraj - Mund të rregullohet me ligj kjo?

Gentian Sala - Ka pasur zhvillime dhe është bërë ligji i ri nga parlamenti për Zyrën e të Drejtës së Autorit. Para një muaji kemi pasur takim me drejtorin e ri të, i cili na ka dhënë neve të drejtë. Ka thënë që agjencia e ka bërë gabim dhe kemi filluar një bashkëpunim të ri. Ti nuk mund t'i kërkes operatorit para, pa i thënë çfarë je dhe kush je. Arrinte puna deri aty sa shkonin nga radiot e Komunitetit Mysliman dhe kërkonin të drejtën e autorit. Shaka që shkojnë në absurd. Edhe ajo është barrë shumë e rëndë për operatorët. Të mos harrojmë që ato agjenci kanë marrë 9 milionë lekë në vit.

Kjo Zyra është zgjidhje.

Megjithatë, edhe kur u bë Zyra, pati konflikte. Televizionet e mëdha i çuan në gjyq, sepse vërtet u bë Zyra dhe ligji, por drejtoria që bënte tarifat, vuri një tarifë 4% të xhiros, që është shumë. Ata thanë që edhe Albtelekomit, që e ka xhiron shtatëdhjetë e ca milionë euro, do t'i merrnin 4% të xhiros.

Kur bëjnë marrëveshjet dhe vendosin tarifat, nuk ulen të flasin.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, ka eksperiencat ndërkombëtare për këto?

Gentian Sala - Ka eksperiencat, por edhe eksperiencat ndërkombëtare ...

Morën rastin e Rumanisë, ndërkohë që mund të merrnin rastin e Austrisë.

Ne kemi një specifikë të veçantë. Jemi ky vend që jemi kaq të varfër sa jemi, dhe prandaj nuk mund t'i thuash që 4% të xhiros e dua unë. Konfliktet u japin të drejtë operatorëve ...

Besnik Baraj – Kjo është temë e vjetër, e ngritur me shumë sensibilitet nga Komisioni Europian.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Shikojmë një frymë të re te....

Bujar Çela – Kam një pyetje për kabllorët që keni licencuar. Shpesh ankohen që kalojnë telat në shtyllat elektrike dhe hasin shumë probleme. Keni ndonjë shqetësim apo informacion nga OSHE-ja?

Gentian Sala – Jo, AKEP-i nxori një vendim para dy vjetëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Mendoni ju, zoti kryetar, që institucioni juaj ka bërë njoftimet e duhura për blerjen e këtyre aparateve digjitale, në mënyrë që të mos ndodhë më ajo që ndodhi?

Gentian Sala – Vazhdon fushata e informimit publik, por kemi bërë disa modifikime, pasi reklama ka formate të ndryshme. Është e pamundur të përsëritet më, pasi një pjesë shumë e madhe janë pajisur me dekodera, kurse një pjesë tjetër, u është lënë

kohë që të pajisen. Janë të paktën 7-8 kompani që importojnë dekodera. Për atë kohë sa importohen, vazhdojnë të shiten.

Fidel Ylli - Sipas informacioneve që kam unë, një pensionist duhet të marrë 2-3 dokumente që ta marrë falas aparatit. Mund të ishte pak më e thjeshtë për ta, në mënyrë që t'u dërgohej në shtëpi?

Gentian Sala – Ata që janë me ndihmë ekonomike, e kanë marrë të gjithë dekoderin.
(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Keni shpërndarë më shumë sesa janë familje me ndihmë ekonomike.

Gentian Sala – Jo ne, por qeveria me ministrinë, por ne kemi qenë grup pune.
(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në këtë moment shesin vetëm privatët. Qeveria ...

Milva Ekonomi – Janë ata me ndihmë ekonomike.

Gentian Sala – Familjet me ndihmë ekonomike i kanë marrë.
(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala - Për të fikur sinjalin analog dhe për të kaluar në transmetim digjital duhet të plotësohet minimumi një kusht, i cili është i parashikuar në strategjinë e digjitalizimit. Strategjia e digjitalizimit është një dokument që ka fuqinë e VKM-së. Realisht është një vendim i Këshillit të Ministrave. Është i detyrueshëm të zbatohet nga institucionet e përfshira në digjitalizimin e mediave audiovizive, sepse nuk është vetëm AMA. Kushti nr.1 është pajisja e të gjithë qytetarëve me dekodera, në mënyrë që asnjë qytetari të zonës ku do të bëhet fikja e sinjaleve analoge, të mos i mungojë sinjali qoftë edhe 1 orë.

Sami Nezaj - Nuk është vetëm AMA e përfshirë në procesin e digjitalizimit, por qeveria, Radiotelevizioni Publik, disa institucione, sidomos Drejtoria e Doganave. Në bazë të një vendimi të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Doganave është e detyruar të monitorojë importimin e këtyre dekoderave sipas karakteristikave që janë të përcaktuara nga qeveria. Unë jam shumë i bindur që AMA do ta ketë shumë të vështirë të marrë një vendim për digjitalizimin e abonentëve në zonën Tiranë –Durrës, në qoftë se ne nuk do të kemi të dhëna, të cilat na sigurojnë që dekoderat janë siguruar nga të gjithë abonentët. Nuk është e lehtë që ne të kemi të dhëna të tilla, që na sigurojnë për këtë shifër ose për këtë moment, por gjithsesi, vetëm pasi qytetarët ta kenë të sigurtë se me fikjen e sinjalit analog, do të kenë mundësi të informohen ...

Milva Ekonomi – Sa është numri i familjeve me ndihmë ekonomike në zonën Tiranë-Durrës?

Gentian Sala – Në Shqipëri janë rreth 10 mijë, kurse në Tiranë-Durrës nuk e di.

Milva Ekonomi – Ky është segmenti më problematik që keni?

Gentian Sala – Ky segment është furnizuar me dekodera.

Milva Ekonomi – Sa pajisje të këtij lloji, sipas Kodit Doganor, kanë hyrë në Shqipëri gjatë këtyre viteve si pjesë importi? Po televizorët që kanë hyrë, e kanë pasur DVB-T2-in të inkorporuar?

Gentian Sala – Kjo nuk është kusht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Nuk e kanë përshkrimin doganor fletët doganore?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala - “Digjitalbi” para pak muajsh ka ...

Fidel Ylli – Nuk po flasim për “Digjitalbin”, por për një kompani që tregton televizorë. Për shembull, unë kam blerë dy televizorë të shtrenjtë, që nuk i kap afati i futjes në treg, por tani vjen puna që duhet të blej përsëri dekoder.

A ka një strategji që ne t’i themi kompanisë që këta televizorë të mos i fusë këtë vit, sepse vitin tjetër do të dalin jashtë loje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kush e ka këtë përgjegjësi? Qytetarët duhen mbrojtur nga institucionet shtetërore, që unë të mos e blej këtë televizor tani, por të pres 6 muaj. Dikush duhet të mbajë përgjegjësi për këtë.

Sami Nezaj – Vendimi i qeverisë ka pasur parasysh cilësinë dhe karakteristikat e dekoderave ...

Fidel Ylli – Pasi kompanitë që tregtojnë televizorë futën 1 milionë televizorë pa këtë pajisje në treg, tani dalin dhe thonë që të gjithë njerëzit duhet t’i blejnë edhe një herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sami Nezaj - Strategjia po, por është bërë njëherë një ...

Me strategjinë e digjitalizimit merret një grup ndërministror. Përveç grupit ndërministror është edhe një sekretariat teknik. Në fakt, fikja e analogut për të kaluar në digjital i përfshin këto dy hallka.

Fidel Ylli – Dikush ka blerë televizorin 2 milionë lekë dhe tani duhet të blejë përsëri.

Sami Nezaj - Komisioni ndërministror ka 2 vjet që nuk është mbledhur fare.

Gentian Sala – Kur janë bërë strategjitë për digjitalizimin, gjithmonë ka ecur nga ajo që është më vulnerabël.

Ne jemi siguruar që televizori i para 10 vjetëve, të mos dalë nga funksionimi. Është marrë parasysh ndihma ekonomike. Italia kur ka bërë digjitalizimin, ka bërë subvencion për të gjithë dekoderat dhe përsëri dekoderi doli 90 euro.

Besnik Baraj – Përgjegjësi e kujt ishte publiciteti, sepse edhe ajo ka nevojë për buxhet?

Gentian Sala – Reklama është bërë. Janë dhënë 7 mijë spote për një vit. Duhet të kemi parasysh edhe se në çfarë territori jemi.

Fidel Ylli - Ju mendoni se do të funksionojë tani në janar apo ka nevojë për shtyrje?

Milva Ekonomi – Po kërkojmë shtyrje.

Gentian Sala – Ky nuk është problem, sepse në fund të fundit, njerëzit po vazhdojnë procesin e marrjes së dekoderave. Sot po ecën shumë më ngadalë. Ne do ta diskutojmë patjetër këtë muaj, por gjasat janë të shtyhet. Ky është mendimi im, se duhet ta diskutoj me bordin, por gjasat janë të shtyhet.

Është edhe psikologjike; njeriu thotë: “të presim edhe një herë”. Më pas...

Fidel Ylli – Mund ta lënë për ditën e fundit, ashtu siç e kemi zakon ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Ka pasur shtyrje edhe herë të tjera.

Ismet Beqiraj – Desha një informacion. Nga momenti që ndodhi ky fenomen dhe deri tani, sa dekoderë janë shitur? A ka ndonjë informacion?

Gentian Sala – Vetëm për ato 2 ditë kemi informacion nga kompanitë, që janë shitur 40-50 mijë dekoderë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në Tiranë dhe në Durrës. Janë 330 mijë familje, që janë parashikuar nga strategjia e vitit 2018 që...

Fidel Ylli - Sa mund të jetë nevoja maksimale?

Gentian Sala – Ju siguroj se që nga data 1 janar që do të mbyllen lotot dhe kjo nuk është shkak, por është shumë serioze, ju nuk e keni idenë se sa aparate televizive do të ketë në qarkullim. Vetëm një pikë eurolotoje në Bllok, më tregojnë djemtë e lagjes që bëjnë gallatë, ka mbi 80 aparate televizive.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Do të bjerë çmimi i aparateve televizive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gentian Sala - Minimumi kanë nga 7-8 aparate televizive, por janë rreth 20 mijë pika bastesh sportive.

Milva Ekonomi – Nëse mund të bëj edhe një pyetje, sepse një nga gjërat që kuptuam herën e kaluar është se përveçse mungonte numri i mjaftueshëm i dekoderëve për familjet e zonës Tiranë-Durrës, një çështje tjetër ishte se edhe ata që e kishin dekoderin, nuk dinin ta vendosnin. Ndërkohë, dihet se në këtë zonë ka shumë familje me persona të vetmuar ose familje me pleq, pa fëmijë dhe pleqtë nuk kishin mundësi ta lidhnin dekoderin. Atëherë, u diskutua se si mund të komunikohet me bashkitë, çfarë mund të bënte pushteti lokal për këtë çështje. A mund të vinte në dispozicion...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Domethënë, e montojnë vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai montim kushton 15 mijë lekë të vjetra, ndërkohë që dekoderi kushton 35 mijë lekë të vjetra.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A do t'i montoni ju, se ne e dëgjuam që ishte problem?

Gentian Sala – Unë ju siguroj se shqiptarët e vënë dekoderin brenda 5-6 orësh mbasi e kanë blerë, herë me një komshi, herë me një tjetër. Probleme do të ketë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ky problem ishte masiv, nuk ishte për 1-2 raste.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Gentian Sala – Si të thuash, ka shumë ekspansion në mënyrën se si bëhet reklama. Reklamat janë bërë më të detajuara, qoftë edhe në procesin e instalimit të dekoderave. Megjithatë, unë përsëri gjykoj që cilësia e reklamave duhet të ishte më e mirë, më e thjeshtë dhe duhet t'i drejtohej një audience, e cila është e pashkolluar ose e paarsimuar, që nuk kupton shumë. Megjithatë, është bërë shumë marketing në këtë kuptim.

Milva Ekonomi – Unë dua të bëj edhe dy pyetje të tjera, sepse ju e dini që ne në prill apo në mars shqyrtojmë raportin vjetor të AMA-s. Këtë raport e miraton Kuvendi brenda muajit maj. Ne, kur miratuam raportin tuaj, ju kërkua diçka që lidhej me menaxhimin financiar. Paratë që mblidhni nga gjobat të përdoren më mire.

A keni filluar këtë vit mbas muajit maj të operoni me më shumë kujdes në regjistrimin e të ardhurave që keni nga gjobat, sipas vërejtjeve që ju bëmë ne?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vera Muça – Jemi në ndjekje të vazhdueshme edhe të pronësisë intelektuale. Janë hapur të gjitha proceset gjyqësore të viteve të shkuara për heqjen e licencave për konstatimin e pavlefshmërisë. Po kështu, po vijojmë me sukses ndjekjen e shpenzimeve të investimeve për vitin 2018 e deri tani.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Kur të vijë raporti këtë vit, do të keni hedhur hapa për ta përmirësuar.

Tjetër gjë e rëndësishme që ne kemi, janë dy rekomandimet që vijnë edhe nga progresraporti i vitit 2017. Në një lloj mënyre sektorin e medias në Shqipëri BE-ja e ngarkon me dy çështje: të bëhet transparencë mbi *ownership*-in e stacioneve televizive dhe ne të marrim disa masa, jo ju si institucion, për të rregulluar sektorin e punës në medie. Ndërkohë, na kanë lënë disa detyra.

A keni ndërhyrë ju në ndonjë prej këtyre? A është marrë ndonjë iniciativë për këtë gjë?

Gentian Sala - Për sektorin e pronësisë, të gjithë thonë se duhet rregulluar, por rrallë thonë se si.

Pastaj, harrojnë një gjë në BE, është viti i parë që ka ndodhur, që qytetarët shqiptarë harxhojnë më shumë kohë në mediet sociale sesa me televizionet tradicionale. Të mos harrojmë se koncepti tradicional i pronësisë që ka qenë para 40 vjetësh, dalëngadalë po sfumohet. Këtë s' duhet ta harrojmë, po të shihni fëmijët tuaj apo vetë ne.

Unë njoftohem nga lajmet e Klanit dhe të TOP-it më shumë nëpërmjet celularit sesa nëpërmjet televizionit. Plus që aty është një informacion jashtëzakonisht i madh. Nuk është se kemi marrë ndonjë gjë konkrete.

Për çështjen e statusit të gazetarit, ne, si AMA, jemi edhe në komunikim me komisionin dhe, të them të drejtën, unë parashikoj të ecet disi më shpejt. Nuk dua t'i paragjykoj ata të zyrës së punës, por kur shoh shkresat që ata sjellin, më duket se ata janë paksa jashtë loje.

Milva Ekonomi – E keni fjalën për Inspektoratin apo për zyrën e punës?

Gentian Sala – Inspektoratin.

Kemi lënë takim në datën 13, sipas shkresës që na kanë sjellë. Na thonë të bëjmë një trajnim të stafit për televizionet. Kjo më duket më shumë si shmangie nga puna. Ç'mund t'i

trajnojmë ne inspektoratit, kur i themi: “Shko zotëri, bjeri derës dhe merr se kush janë punonjësit e institucioneve!”

Nëse do të na thoshte inspektorati të shihnim titrat, të marrim emrat e gazetarëve dhe të kontrollojmë nëse janë apo nuk janë të siguruar, ky mund të jetë bashkëpunim me njëri-tjetrin, por jo të na thonë që të trajnohemi ne. Kjo është t’i bësh bisht punës, sipas gjyqimit tim. Megjithatë, nuk po i paragjykojmë, se në datën 13 kemi lënë takim dhe aty do t’i dëgjojmë se çfarë kanë për të thënë.

Fidel Ylli – Unë kisha këtë pyetje: A e keni analizuar ju në këto 5 vjet ligjin tuaj organik nr. 97/2013? A mendoni se mund të ketë nevojë për ndonjë ndryshim dhe ku konsiston ai, meqë flitet edhe për rregullimin e medieve *online*?

Gentian Sala – Për mediet *online* nuk është se është problemi i ndryshimit të ligjit aktual sesa çështja që koha të vë para përgjegjësive të tjera. Unë e kam parë draftin. Nuk e kam parë thjesht, por nuk është sekret ta them, që kam marrë pjesë në një grup pune, unë si kryetar, jo bordi, se ai ka detyra të tjera, që i vihen vetëm mbasi komisioni i kërkon mendim. Kjo nuk na vë në përgjegjësi për të marrë pjesë në grupet e punës që thërret KM-ja.

Unë them që jemi pak vonë për mediet *online*. Kemi mbetur vonë nga frika se po hyjmë në BE dhe mos prekim ndonjë nen që prish balancat e demokracisë, por në çdo takim me autoritetet e tjera ku ne marrim pjesë, 5-6 në vit, mediet, interneti janë A-B-C-ja e diskutimeve. Të merremi ne sot këtu me të drejtën e fëmijëve në TV, çfarë thotë RTSH-ja, çfarë thonë të tjerët, më mirë merr celularin ose shko te lodrat dhe sheh se aty ka lojëra me thika, me shpata e të tjera.

Pra, o do t’i dalim në ballë punës, o do të themi se këto janë rekomandimet e BE-së, të OSBE-së e të tjera.

Unë këtë punë e shoh në kompleks dhe e shoh pa frikë. Projektligjin e pashë.

Fidel Ylli – A ka nevojë për ndonjë ndryshim?

Gentian Sala – Të them të drejtën m’u duk pak i ekzagjeruar te gjobat, sepse ti, sado që mediet *online* mund të kenë rëndësinë e vet, nuk mund t’u vësh gjoba më të mëdha se ato që i vë televizioneve për çështje etike, balancimi etj., sepse në ligjin tonë gjoba është nga 400 mijë lekë në 4 milionë lekë të vjetra për televizionet dhe nuk mund t’u vësh medieve *online* gjoba nga 1 milionë lekë në 10 milionë lekë të vjetra, se nuk shkon si logjikë.

Milva Ekonomi – Sa përqind të reklamave menaxhonin mediet *online*, sipas raportit që ka bërë instituti?

Gentian Sala – Me gjithë *Facebook*-un e të tjerat *online*, është më shumë se 10%. Nuk besoj se është më shumë se 5-6%.

Milva Ekonomi – 38 milionë euro ishte xhiroja vjetore. 30 milionë euro e kishin televizionet.

Gentian Sala – Dihet që mediet *online* mund të kenë edhe para të zeza.

Sami Nezaj – Po nisem te transparenca e pronësisë së medieve. Unë do të gjykoja që parlamenti ndoshta mund ta fusë në ligj, që mediet të mos kenë pronarë të regjistruar në parajsat fiskale, duke pasur parasysh që produkti i industrisë mediatike është shumë më sensitiv dhe me një ndikim shumë më të madh te qytetarët sesa produktet e industrive të tjera. Një transparenca e plotë e pronësisë do të ishte në një farë mënyre një garanci për produktin.

Së dyti, në lidhje me ndryshimet, të cilat mund t'i bëheshin ligjit...

Milva Ekonomi – E kishit fjalën për të gjitha mediet apo vetëm për mediet *online*?

Sami Nezaj – Këto kalojnë përmes pronësisë...

Shteti u jep atyre një pjesë të pronës në përdorim, që janë frekuencat. Unë nuk e kisha për mediet *online*.

Milva Ekonomi – Edhe ato duhet të jenë.

Sami Nezaj – Unë e kisha për mediet audiovizive. Megjithatë, unë thjesht po e hedh si mendim se çfarë mendoj, nëse duhet të bëhet diçka e tillë ose të paktën të diskutohet se si mund të kryhet.

Së dyti, Gjykata Kushtetuese ka ndërhyrë në ligjin organik të AMA-s përmes heqjes së një paragrafi të nenit 64, që lidhet me pronësinë. Heqja e atij paragrafi ka krijuar në fakt një farë zhurme brenda atij neni, por edhe brenda vetë ligjit, sepse në një farë mënyre është cenuar një prej parimeve kryesore që ka pasur ligji, i cili do të shmangë atë që quhet përqendrim i pronësisë së medieve në duart e pak pronarëve.

Jam dakord me kryetaren, e cila thotë se tani do të kemi diversitet shumë të madh në tregun mediatik, që nuk është vetëm audioviziv, por është edhe tregu që vjen përmes medieve *online*, përmes internetit ose teknologjive të tjera. Megjithatë, tregu që vjen përmes frekuencave shtetërore nuk duhet të jetë i monopolizuar, as s' duhet të jetë në formën e një *oligobondi*.

Së treti, aty ka nevojë për ndërhyrje për ta përshtatur ndryshimin që ka bërë Gjykata Kushtetuese në ligj me nenet e tjera dhe me paragrafët e tjerë të këtij neni.

Së katërti, unë dua të ngre një problem, i cili është ngritur edhe më parë nga anëtarët e Bordit të AMA-s, për shpërblimin e anëtarëve të Bordit të AMA-s. Ky shpërblim është gati

një herë më i vogël sesa shpërblimi i anëtarëve të Bordit të RTSH-së, ndërkohë që ngarkesa e anëtarëve të Bordit të AMA-s është jashtëzakonisht e madhe. Ne, në një mbledhje bordi, mund të shqyrtojmë materiale deri në 400 faqe dhe kjo nuk vjen për shkak të grumbullimit të materialeve nga administrata apo për shkak të vonesave të mbledhjeve.

Milva Ekonomi – Po, na keni sjellë një letër ku e kërkon këtë.

Gentian Sala – Ne shqyrtojmë deri në 400 faqe në një mbledhje. Ne u themi anëtarëve të bordit që duhet të shqyrtojnë. Pra, të shqyrtosh me seriozitet 400 faqe material për një mbledhje, mendoj se ata duhet të respektojnë edhe përgjegjshmërinë gjatë shqyrtimit të këtij materiali.

Ata kanë një pagesë shumë të vogël, minimale...

Milva Ekonomi – Ju na keni bërë një kërkesë për këtë gjë dhe në qoftë se ju kujtohet, ne këtë gjë e kemi diskutuar edhe me ju, si dhe shkuam në Ministrinë e Financave, pasi janë ata që japin mendim për klasën e pagave, por ata e refuzuan.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne do ta vazhdojmë përpjekjen dhe nuk do të heqim dorë...

Gentian Sala – Për ta bërë këtë gjë më konkrete ne e kemi 260-270 mijë lekë, vajzat e mia e kanë 1 mijë euro, ndërsa në Kosovë anëtarët e kanë 800 euro, të cilët nuk janë *full time*, për të mos thënë për ata të BE-së...

Milva Ekonomi – Edhe ne deputetët në Shqipëri e kemi rrogën 900 euro, ndërsa në Kosovë e kanë 2500, por kësaj nuk kemi çfarë t'i bëjmë. Ndërsa në vende të tjera është ndryshe...

Almira Xhembulla – Meqenëse jemi te modeli i Kosovës, nuk e di se sa bashkëpunim ka media jonë audiovizive, se si përcillet dhe ndiqet atje. A kanë ata një bashkëpunim me Kosovën, Maqedoninë? Si funksionon kjo gjë apo është thjesht një bashkëpunim homologësh?

Gentian Sala – Me Kosovën kemi një bashkëpunim shumë të madh, sepse, në radhë të parë, mediet ne vetëm i shajmë, por në Shqipëri ky është eksporti ynë kryesor. Ne prej 10 vjetësh kemi një bashkëpunim me Kosovën dhe Maqedoninë, që është treg me të paktën 150 milionë euro që xhiron media, ku një pjesë vjen nga reklamat, një pjesë nga siglat...

Milva Ekonomi – Në këto vende?

Gentian Sala – Në Shqipëri.

Milva Ekonomi – E të gjitha medievet?

Gentian Sala – TVSH-ja, Digitalbi, TOP-i, e të tjera, pra është një ndikim shumë i madh. Marrin lekë nga reklamat, nga *subscriptions*, nga *fee*-ja që merr RTSH-ja nga qytetarët.

Pra, ky është ndikimi kryesor që ka media shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni, janë mediet më të para, flas për mediet shqiptare në Maqedoni. Mediet tona në Kosovë, sidomos kompanitë Tring dhe Digitalb hasin shumë vështirësi. Këtë gjë duhet ta themi, nuk është turp. Gjithashtu, ua kemi thënë edhe homologëve tanë, pasi shohim një lloj ngurtësimi. Marrëdhëniet i kemi shumë të mira, por nuk e di nëse bën fajde, apo jo?

Nga ana tjetër, çfarë kemi bërë ne për mediet në Kosovë? Kemi bërë atë që kemi vajtur personalisht me kryetarin dhe me stafin, duke bërë vetë kontrata me gjithë televizionet kombëtare në Kosovë, ato 3-4 që janë atje, për t'i trajtuar operatorët kabllorë, për t'iu marr një lloj autorizimi që të gjithë operatorët kabllorë në Shqipëri t'i ritransmetojnë me të drejta. Pra, nuk kemi lënë një operator që të shkoj dhe të bëj kontratë për RTK21-in, por kemi marrë ne një autorizim nga ata dhe që na kanë dhënë të drejtën të transmetojmë. Sot të gjitha televizionet kabllore në Shqipërinë kanë...

Milva Ekonomi – Kanë akses atje?

Gentian Sala – Këtu te ne kanë akses, pasi operatorët tanë kabllorë marrin te televizionet e Kosovës dhe i transmetojnë të gjitha. Pra, kjo gjë duhet të jetë, pasi krijohet edhe një lloj imazhi. Televizionet tona në Kosovë janë pa diskutim numri një, kurse në Maqedoni influenca është goxha e madhe. Marrëveshjet e bashkëpunimit i kemi kryer që vitin e parë apo vitin e dytë, ndërsa vitin e fundit kemi diskutuar më shumë për digjitalizimin, sepse procesi i digjitalizimit në Kosovë është goxha mbrapa. Eksperiencën tonë si atë pozitive, por edhe atë negative ju e keni...

Besnik Baraj – Duke parë ndikimin e televizionit në shoqëri në përgjithësi, a keni precedent në të cilin një organizëm i ngjashëm si ju të propozojë rregullimin e raporteve të programit? Ndoshta, duket jo normale, por unë mendoj që televizionet në një masë të konsiderueshme i helmojnë njerëzit, pasi dominohen aq shumë nga programe, të cilat si nga pikëpamja etike, ashtu edhe nga pikëpamja politike, ndikojnë te shqiptarët aq sa ata kalojnë pjesërisht në depresion...

(Diskutime pa mikrofon.)

Arben Muka – Për të krijuar një fokus, kjo zgjidhet jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse na e ndalon ligji, veprimtaria televizive është e lirë, skaletat, skedat programore dhe çdo gjë tjetër bëhet duke respektuar ligjin dhe ritransmetimin, dhe duke rregulluar kasën. Sigurisht AMA nuk e ka parë këtë si bëhet, ose të thotë “në rregull, bëjeni vetë”, krahas një retorike që ne bëjmë për shqyrtimin e tematizuar, që do të thotë 1 javë, 3 ditë, 10 ditë për përmbajtjet e caktuara, atëherë sa do ta respektojmë ligjin? Përveç shqyrtimit që bëjmë rast pas rasti në

fushën e ankesave, kemi edhe një element tjetër që e kemi futur në vitin 2015, kur ne kemi bërë pakt me organizatat, pra dua t'i përgjigjem pyetjes që ju ngritët, në patnership me organizatat që punojnë në fushën e medies. Kjo do të thotë që me të vërtetë nuk duhet t'i trajnojmë..., sepse jemi amatorë dhe shohim se sa zbatohet në projektligj, por në sinergji me Institutin Shqiptar të Medies, me disa organizata që kanë eksperiencë në fushën e kualifikimit dhe ato që janë prioritet për ne, por jo për rregullatorin tonë, por edhe për gjithë rregullatorët në vendet fqinje dhe të Bashkimit Europian, mbrojtja e fëmijëve, gjuha e urrejtjes, elemente të diskriminimit, si dhe disa elemente të tjera që janë bazike, ne i vëmë në fokusin e kualifikimeve dhe të trajtimeve të *workshopeve*.

Pra, nuk kemi se çfarë t'u bëjmë, se ata i bëjnë vetë programet, nuk ua bëjmë ne, por ama ne ndikojmë në këtë aspekt, duke u dhënë mbështetje këtyre organizatave për të bërë kualifikimin. Madje, jo në Tiranë, sepse Tirana në një farë mënyre i merr mesazhet kualifikuese, trajnuese, por më shumë nëpër rrethe. Ky është një element që ne e kemi gjetur, por monitorimi dhe bërja me dije e rezultateve të vlerësimit dhe të monitorimit, edhe kur është parë që në këtë aspekt, për shembull, te reklamat e fëmijëve, te studimi i fytyrës së fëmijës ose skenat e dhunshme pornografike, kjo e bën këtë gjë më konkrete....

Milva Ekonomi – A ka një diskutim të poshtëm? Ajo që po ju them tani ka pak karakter filozofik dhe jo aq shumë etik. A ka një kufi të poshtëm ku ju monitoroni? Nga njëra anë, unë kam të drejtën të informohem, është e drejta ime themelore kushtetuese të informohem, nga ana tjetër, kam të drejtën të shprehem, por ndërkohë në televizion ka diçka që është shumë....Pra, a ka një kufi të poshtëm të monitorimit? Ju nuk mund ta lejoni... Ne shohim programe edhe te stacionet e tjera, të paktën unë kuptoj anglisht dhe italisht për ta ndjekur programin në rregull. Unë nuk kam parë as te Hienat, as te programe të tjera të huaja, që janë tip Fiksi, apo Stopi, gjuhën që përdorin Fiksi dhe Stopi. A ka një nivel të poshtëm kontrolli...

Gentian Sala – Çështjet e etikës janë pak të gjëra...

Milva Ekonomi – Po marr shkas edhe nga pyetja që bëri Besniku, a ka një nivel, ndoshta ju nuk e bëni dot direkt, por keni një detyrë kontrolli...

Gentian Sala – Do t'ju them unë për rastin e fundit me Stopin dhe me Fiksin...

Bujar Çela – Thuhet kudo që fëmijët nuk mësohen me lekë, ndërsa te Klani shohim një emision tani ku një fëmijë thotë fitova 100 mijë lekë. Pra, u jepen lekë fëmijëve...

Nuk e di nëse për familjen...

Besnik Baraj – Të flasim më konkretisht. Një shqetësim të tillë e kam ngritur para kampionatit botëror, pasi shihja personazhe, madje personazhe politikë, të cilët i ftonin nëpër emisione për të vënë bast për lotot. Në këtë rast ju si institucion a keni ndonjë rol?

Gentian Sala – Kemi rastin e fundit me Stopin, i cili tejkalon çdo lloj komunikimi dhe jep informacion për shërbimin inteligjent të ushtrisë, duke komunikuar në mënyrë zyrtare dhe jo zyrtare. Pra, duke komunikuar në mënyrë zyrtare me ata djemtë e Stopit dhe jo zyrtare me zotin Frangaj e të tjera. Jo zyrtarisht u tha që u ndalua, ndërsa në mënyrë zyrtare kemi dërguar shkresën që të ndalohet 1, 2, 3 apo 4. Pra, këto janë raste ekstreme dhe vetëm ata mund t'i dinë. Po ashtu, kemi rastin e Fiksit, një debat i madh, sepse vërtet bëhet një emision për mbrojtjen e fëmijëve, si rasti i një fëmije në gjakmarrje, por mënyra se si bëhet transmetimi i fëmijës që komunikon me gazetarët, është jashtë çdo lloj norme etike dhe morale, aq sa edhe sytë ia mbulojnë lehtë fare. Komunikimi me ta ndalohet në mënyrë kategorike. Ne, më pas, i dërguam një shkresë, por ata na thanë se e kishin lexuar përgjysmë, por që kuptohet se ku qëndron problemi. Këtu, në njëfarë mënyre, situata është jashtë çdo lloj norme, por, siç jua thashë, te fëmijët ka goxha përmirësim.

Rasti i llotove. Reklamat për llotot i ka pasur ligji për lojërat e fatit. Ne nuk jemi marrë me atë, duke thënë se, meqë e kanë ata, nuk merremi ne, por ankesat na kanë ardhur neve dhe ne i kemi dërguar të paktën 4-5 shkresa drejtorisë. Në dy raste janë vënë gjoba dhe në dy raste të tjera lajmërim, a ku e di unë se çfarë kanë marrë. Pra, kësaj çështjeje iu dha drejtim, ndërsa drafti i ri për lojërat e fatit është futur te mediet audiovizive, ndalohen *online*, *offline*, TV, çdo lloj komunikimi reklame për këtë fushë. Pra, do të ecim pak ngadalë, por e rëndësishme është që të shkojmë përpara.

Almira Xhembulla – Unë, si përfaqësuese e komisionit, kam qenë të paktën në dy tryezat e para që janë organizuar nga këshilli i ankesave dhe besoj se kjo lidhet edhe me shqetësimin që ngriti Besniku. Pra, këto çështje i kam ndarë edhe me kolegët, një prej tyre ishte për edukimin dhe medien, ndërsa tjetra ishte për gjuhën e urrejtjes. Dy organizime shumë cilësore dhe eficiente, me pjesëmarrjen e ekspertëve më të mirë të medias, por edhe me pjesëmarrjen e gazetarëve në terren apo të përfaqësuesve të institucioneve që merren me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve e të tjera. Ndërkohë, AMA në një farë mënyrë bën rolin edukues dhe informues, por sa i përket kësaj, jo vetëm thjesht të marrjes së masave nga ana teknike, por ndërkohë bëhet një punë paralele, e cila besoj se është një vlerë e shtuar e këtij institucioni në këtë drejtim.

Ismet Beqiraj – Duke marrë shkas nga shqetësimi që u ngrit këtu, por edhe nga çështjet që kemi trajtuar radhës tjetër lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe këto lajmet ekstreme, jo vetëm në këto emisione, por po marr edhe emisionet që kanë një audiencë më të gjerë, si “Portokallia”, “Al pazari”, të cilët përdorin një fjalor që nuk është në etikën e shqiptarëve dhe të kulturës. Aty nuk vendoset me pullë të kuqe që ky emision është për moshën mbi 18 vjeç dhe ata që janë nën këtë moshë nuk duhet ta ndjekin.

Lajmet që jepen. Hapen lajmet dhe mbyllen për 24 orë, ndonjëherë në mes të emisioneve lajme flesh me kronika të zeza. Pra, bie në shtrat me kronika të zeza, ngrihesh në mëngjes me kronika të zeza. Nuk i kemi parë këto as në vendet fqinje, si në Itali apo edhe në vende të tjera, pasi lajme të tilla janë më të selektuara, gati sa njerëzit mendojnë se ku do të dëgjojnë ndonjë aksident apo ndonjë ngjarje të tillë. Ndoshta edhe këtu në tryezën tonë, që në mëngjes kur jepen titujt e gazetave tona të famshme bombastike, që në faqen e parë, jo vetëm ta prishin humorin, sidomos neve që kemi marrë hovin e politikanit dhe përgjegjësinë, do t'i presim edhe këto, por të krijojnë një shqetësim, po flas në gjuhën popullore, shoqëror dhe në të gjithë sojin e sorollopin.

Në faqe të parë të nxijnë jetën dhe brenda kush e lexon, thotë “ç’është kjo”! Emisione të tilla, shqetësime të tilla duhet të monitorohen dhe këta që prishin klimën shoqërore dhe cenojnë personalitetin dhe kredibilitetin e njerëzve padrejtësisht, të ndëshkohen...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Në qoftë se do të flasim sinqerisht për këtë punë, se kjo është shumë delikate, programacioni...

Fidel Ylli - Nuk e di si është deri te kriteri kur merr licencën! Mediat janë turrur, ai që hap një media sikur krijon një parti më vete dhe e përdor si top për të baltosur të tjerët.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Fjalën e ka Bujari për procedurë.

Bujar Çela – Edhe unë e kam marrë patentën... Mund ta bëj unë mbylljen?

Ismet Beqiraj - Mbylljen e bën kryetarja. Ti ke të drejtën të flasësh.

Milva Ekonomi - Do ta japim fjalën, por ka edhe dy pyetje të tjera dhe pastaj do ta mbylлим.

Në Bashkimin Europian ka një ligj të ri, rregulla të reja për autoritetet rregullative të medias. A ju ndihmon kjo gjë? A e shikoni pozitive edhe pse nuk jemi anëtarë të BE-së, ju udhëheq sadopak në punën tuaj?

Gentian Sala - Unë nuk u çudita fare nga direktivat, sepse ka dy vjet që çdo autoritet diskuton vetëm për atë. *Online*-i është bërë problem, siç i ka dhënë shumë të mira demokracisë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Pyetja ime e dytë është kjo: kur na sollët raportin, thatë që ju janë lënë disa këshillime, zbatime a rekomandime, urdhëresa që ndahen sipas kategorive, vërgjani emrin si të doni, nga KLSH-ja. Keni marrë masa për t'i zbatuar këto rekomandime e urdhëresa?

Gentian Sala - Pothuajse të gjitha! Edhe ato financiare.

(Diskutim pa mikrofon.)

Nuk i gjykuam janë të drejta apo jo!

Milva Ekonomi – Pjesa e parë është legjislative, që ju jeni në linjë, pjesa e dytë është Kontrolli i Shtetit, për pjesën ekzekutive të jepte detyra. Ndaj i ndava në dy kategori pyetjet.

Keni pyetje të tjera, kolegë?

Fidel Ylli - Kam unë një pyetje. Për mendimin tim, bordi i AMA-s është shumë i rëndësishëm. Kohët e fundit patëm një rast që u shqyrtua në komision dhe nuk kemi dalë ende me një vendim, se po presim disa institucione të na japin përgjigje për një anëtar të AMA-s, ku sipas mediave dhe pas një shkrese të dërguar Kryetarit të Parlamentit, një anëtar i AMA-s ka konflikt interesi. Mendoni ju, pasi nuk jeni ndoshta institucioni që bëni verifikimin e kësaj pune, ka edhe anëtarë të tjerë të AMA-s që kanë konflikt interesi?

Gentian Sala - Po të kisha informacion, do të njoftoja Kuvendin.

Fidel Ylli -Ju nuk e keni këtë informacion?

Milva Ekonomi – Përgjegjësia është personale, sepse çdo anëtar firmos një letër ku shprehet që nuk ka konflikt interesi.

Gentian Sala - Anëtarin që kisha, e nisa.

(Diskutim pa mikrofon.)

Siç kërkojnë disa të ikë kryetari, AMA këtë punë ka!

Fidel Ylli – Për mua AMA është një institucion shumë i rëndësishëm dhe duhet që të paktën anëtarët e bordit që zgjidhen nga parlamenti, të jenë figura të pastra e të mos kenë konflikt interesi. Në këtë aspekt e kisha.

Milva Ekonomi – A kemi çështje të tjera për të ngritur?

Për procedurë, së pari, ju falënderoj që u mblodhët të gjithë bashkë sot, sepse axhenda jonë ishte me disa pjesë, ndaj edhe ne e lamë në orën 12.30, por edhe pse axhenda nuk

funksionoi e gjitha, sërish komisioni ishte në orar poshtë zyrave të AMA-s. Faleminderit anëtarëve që kishin kaq shumë dëshirë të takoheshin me ju!

Së dyti, faleminderit juve që na pritët në këtë godinë, që ne e kishim parë vetëm nga jashtë të rikonstruktuar, por ndërkohë na pëlqeu shumë mjedisi! Komplimente për logjistikën!

Së treti, komplimente për stafin, sepse mendoj që stafi që ju ka shoqëruar sot në mbledhje, është një staf profesional edhe për ndërhyrjet, edhe për mënyrën se si dinë të dëgjojnë, kur ka probleme dhe kur duhet të japin përgjigje. Faleminderit për disponibilitetin që treguat!

Për ne ishte një takim i rëndësishëm, pasi kishim disa çështje për diskutim, si diskutimi i ligjit të ri të autoriteteve në BE, që ju e keni parashikuar; raportin e Kontrollit të Shtetit që ju e keni në zbatim; dezinformimin online që ju po e ndiqni; monitorimin e ankesave; digjitalizimin ose digjital dividentin, që ju e keni në ndjekje; që dini ku janë problemet e ku do të ndërhyni. Nga ana tjetër, morëm me vete një kërkesë nga ana juaj për pagat e bordit. Ne i kemi bërë një letër Ministrisë së Financave, ata kanë reaguar dhe ne do të vazhdojmë të bëjmë një kërkesë tjetër për të pasur mundësi që sërish të shikohet...

Fidel Ylli - Sa i ka RTSH-ja pagat e bordit?

Gentian Sala – Rreth 480-500 mijë lekë të vjetër.

(Diskutim pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Këtë nuk e vendosim dot ne, do ta diskutojmë sërish me Ministrinë e Financave.

Ne kemi një kërkesë në ndjekje për konflikt interesi. Ju na vutë në dijeni për një gjë mediatike dhe ne ndoqëm ecurinë e gjithë procesit. Tashmë jemi në konkluzionin e marrjes së informacioneve finale dhe ne, si komision, do të nxjerrim një përfundim. Mendoj se keni më shumë nevojë për mbështetje nga ana e komisionit lidhur me ndryshimet ligjore, që mund të pësojë ligji i kontrollit dhe mediave audiovizive në Shqipëri. Po për këtë arsye, do të doja t'ju bëja thirrje që të kemi një bashkëpunim të ndërsjellë mes jush dhe komisionit, për të ndarë mendimet, opinionet dhe shqetësimet tuaja.

Unë kam ndjekur disa herë takimet që ka bërë OSBE-ja për mediat dhe institucionet e tjera që lidhen me fushën mediatike, siç është Instituti Shqiptar i Medias. Ajo që kam vënë re dhe që më bën përshtypje, është se niveli i diskutimit atje, nuk të lë mbresa qoftë mendimi, qoftë mbresë pozitive dhe, mbase, AMA duhet të hapet pak edhe me një kalendar për të diskutuar çështje të tjera, përveç ankesave. Nuk e di se sa mundësi keni me këta operatorët e ndryshëm për t'i...

(Diskutim pa mikrofon.)

Kam parë disa nga të dhënat e botuara për Shqipërinë dhe në harkun kohor të 10 vjetëve progresi që është bërë në mediat shqiptare, mua më duket shumë pozitiv e mbresëlënës, se nuk ma do mendja që progresionet tuaja të ndodhin shpejt, pasi sektori është aq i madh dhe do të marrë pak kohë që kur ju nxirrni një rregull, sistemi të lëvizë vetë. Ka ulje dhe ngritje, nuk diskutohet, dhe kjo ndjenja e optimizmit për t'i bërë më mirë gjërat, nuk është pjesë e atyre që punojnë në sektorin e mediave. Këtë mbase duhet ta shohim bashkërisht, për të vendosur një frymë të re komunikimi.

Gentian Sala - Unë mendoj që duhet të bëhemi ne më shumë iniciatorë, siç jemi bërë, dhe nuk duhet të presim që të na e sugjerojë BE-ja.

Milva Ekonomi – Në konferencë propozova diçka që lidhet me pjesën e raportit. Në qoftë se gazetarët nuk arrijnë të thonë se sa e kanë rrogën, janë të siguar apo jo, janë të mirëpaguar apo jo, se kanë pasigurinë e vendit të punës, ka forma të ndërthorta për ta kuptuar këtë gjë. Ne kemi 2700 gazetarë, 735 prej tyre janë nëpër shoqata, se sindikata nuk ka, këta 735 që hyjnë në një shoqatë regjistrohen me një ID, ne marrim një numër celulari dhe regjistrohemi me ID, ID-ja ka numrin tim personal, i cili më bën mua të gjurmueshëm te sigurimet. Në qoftë se unë shikoj sa sigurime kam derdhur, me një rregull treshi llogaris pagën që kam marrë. Në qoftë se nuk bëjnë dot as për këtë, atëherë le të kërkojnë vetë gazetarët që të bëjnë deklarin e formularit tek tatimet, që bëjmë të gjithë çdo vit, në pagën 20 milionë lekë të vjetër të fituar në vit apo më pak. Po bëjmë këtë deklarin, ka edhe një formë edhe më të tërthortë se si e ke dinjitetin në punë, se ndryshe me fjalë kjo nuk monitorohet dot. Këtë gjë, mbase, mund ta bëni me një projekt kërkimi bashkë me Inspektoratin e Punës, pasi duhet që kontratat të jenë 1-vjeçare.

Gentian Sala - Kontrata është mirë të jetë kontratë fikse, sepse pagat nuk janë si para 3-4 vjetëve.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, kontrata fikse është 1, 2, 3 –vjeçare?

Gentian Sala - Unë them që të bëjmë një takim tjetër, si takimi i parë që bëjmë në mars, që të dalim me një dokument më të prekshëm, sepse edhe zyrat e punës mund t'i vëmë më tepër në lëvizje, por këtë iniciativë duhet ta marrim. Ky vit ndoshta është vonë, por në janar do të ishte mirë të realizohej ky takim.

Milva Ekonomi – Për gjërat që do të donit t'i çonit përpara, ne do të na keni gjithmonë mbështetje.

Ju urojmë gëzuar festat!

Komisioni vijon me vizitën nëpër ambientet e AMA-s.

MBYLLET MBLEDHJA